



Pranuar / Doretuar Punë/Prodato Received/Delivered	22.02	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednitsa Org / Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicema Quantity
SKAMSHUK	758/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.14/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.14/2021 të datës 14.01.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Tasim Elezi", Matiçan në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit me Nr.14-118/02-222330/20 të datës 04.12.2020 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin I nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin I nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.14/2021 e datës 14.01.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr.14-118/02-222330/20 i datës 04.12.2020 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 14.01.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 147/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin kundër Vendimit me Nr.14-118/02-222330/20 të datës 04.12.2020 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për përfundimin e marrëdhënies së punës me raste të pensionimit të cilin e ka pranuar më datë 24.12.2020 duke theksuar që nuk i është njohur e drejta e kompensimit prej tri pagave me rastin e pensionimit siç parashihet me Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Komunën e Prishtinës. Më datë 29.01.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 147/2021 të datës 14.01.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.14-118/02-222330/20 të datës 04.12.2020 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Kërkesë për pagës retroaktive dhe përgjigjen në ankesë e datës 29.01.2021,

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi i punësuar në pozitën “Nëpunëse Administrative-Financiare” në Komunën e Prishtinës, në bazë të Vendimit me Nr.14-118/02-222330/20 të datës 04.12.2020 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës i është përfunduar marrëdhënies e punës me rastin e pensionimit prej datës 03.01.2021 duke i'u njohur e drejta e kompensimit të një page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit 482.46 Euro, kjo pagesë i është bërë në janar 2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që nuk i është njohur e drejta e kompensimit prej tri pagave me rastin e pensionimit siç parashihet me Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës..

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses, ka konstatuar se Marrëveshja Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 ndërsa sipas nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, është përcaktuar që: **“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”**, mbi bazë të kësaj mund të konstatojmë që kjo marrëveshje ka qenë në fuqi deri më datë 01.01.2018 si rrjedhojë nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike, ndërsa e njëjta nuk është nënshkruar më nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi që ka konstatuar se përfundimi i marrëdhënies së punës së ankueses me rastin e pensionimit sipas Vendimit me Nr.14-118/02-222330/20 të datës 04.12.2020 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës ka ndodhur më datë 03.01.2021, rrjedhimisht kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk mund të bëhet, mbi këtë bazë pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, meqenëse konstaton që Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk është në fuqi, atëherë kompensimin me rastin e pensionimit të nëpunësve civil bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, rrjedhimisht Komuna e Prishtinës ankueses i ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit, sipas dispozitave të nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: **“Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit”. Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e**



marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit”, kështu që Komuna e Prishtinës ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka konstatuar se Vendimi me Nr.14-118/02-222330/20 i datës 04.12.2020 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës është nxjerr në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.14/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.